



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:093837

Datë: 25.07.2024

Numri i dokumentit: 05978172

C.nr.541/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ në çështjen juridike kontestimore të paditësit H. U. nga fsh. . . ., Komuna Gjakovë, kundër të paditurit B. K. S., me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës” Magjistralia Prishtinë Fushë Kosovë, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e objektit të kontestit 2500.45 Euro, në seancën përgatitore mori, ndërsa me datë 25.07.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit H. U. nga fsh. . . ., Komuna Gjakovë kundër të paditurit B. K. S. BKS me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datë 07.08.2020, kanë paraqitur padi kundër të paditurit B. K. S. BKS me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka caktuar disa herë seancën përgatitore dhe atë me datë 10.05.2024; 03.06.2024; 01.07.2024 të cilat për arsye të ndryshme të paditësit (si në shkresa të lëndës) i ka shtyrë, kurse prap me datë 25.07.2024 ka caktuar seancën tjetër përgatitore, në të cilën seancë ka prezantuar i autorizuari i të paditurës BKS, mirëpo nuk ka prezantuar e autorizuar e paditësit, edhe pse kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, ashtu siç vërtetohet nga

flete dërgesa për dorëzim personal, dhe mungesën për këtë seancë nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë.

Gjykata në mbështetje të nenit 409, par.1 të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, dhe duke marrë parasysh se në rastin konkret e autorizuara e paditësit ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën për seancë nuk e kanë arsyetuar, erdhi në përfundim se padia e paditësit duhet të konsiderohet e tërhequr në këtë çështje kontestimore.

Vendimin rreth shpenzimeve procedurale gjykata e mori në mbështetje të nenit 450 dhe 463.1 dhe 4 e LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe në mbështetje të nenit 409, pika 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.541/20, me 25.07.2024.

Gj y q t a r j a
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.